

VENDIM
Nr. 70/2024

PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT PËR AUDITIMIN E SEKTORIT PUBLIK

Në mbështetje të neni 78, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financat.

II. Fusha e përgjegjësisë së nënkomisionit përfshin shqyrtimin objektiv të zbatimit të buxhetit të shtetit dhe rritjen e ndikimit të proceseve të auditimit. Qëllimi kryesor i nënkomisionit është të rrisë transparencën dhe llogaridhënien dhe të kontribuojë në përmirësimin e ekonomizimit, efektivitetit dhe efikasitetit në përdorimin e burimeve publike. Gjithashtu, nënkomisioni do të sigurojë llogaridhënien e KLSH-së në Kuvend, pa ndërhyrë në pavarësinë e institucionit.

III. Kompetencat e nënkomisionit janë:

a) shqyrtimi i raporteve të qeverisë për zbatimin e buxhetit të shtetit, i raportit të KLSH-së për zbatimin e buxhetit të shtetit dhe raportimi i gjetjeve;

b) shqyrtimi i raporteve të auditimit të KLSH-së, ndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe raportimi i gjetjeve;

c) organizimi i seancave dëgjimore për çështjet të cilat janë pjesë e fushëveprimit dhe kompetencave të nënkomisionit;

ç) vendimmarrja, dhënia e rekomandimeve dhe trajtimi i përgjigjeve nga institucionet përkatëse;

d) paraqitja e raporteve dhe trajtimi i përgjigjeve apo propozimeve të tjera për çështje të cilat janë pjesë e fushëveprimit dhe kompetencave të nënkomisionit;

dh) shqyrtimi i raportit vjetor të performancës së KLSH-së dhe raporteve të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të KLSH-së;

e) shqyrtimi i projektbuxhetit vjetor të KLSH-së dhe raportimi i gjetjeve të Komisionit për Ekonominë dhe Financat;

ë) ndërmerri procedurat për përzgjedhjen e audituesve të jashtëm të llogarive të KLSH-së dhe ia paraqet rekomandimet Komisionit për Ekonominë dhe Financat;

f) paraqitja e raportit vjetor për veprimtarinë e tij.

IV. Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë si më poshtë:

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1. Emilja Koliqi | kryetare PD |
| 2. Enslemvera Zake | zëvendëskryetare PS |
| 3. Alban Xhelili | anëtar PS |
| 4. Pranvera Resulaj | anëtare PS |
| 5. Sorina Kote | anëtare PD |

Anëtar zëvendësues:

Antoneta Dhima PS

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratur në datën 25.7.2024